



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture,  
Omladine i Sporta /Ministry of Culture, Youth & Sports  
Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale  
Agencija za Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova  
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

Komuna Hani i Elezit  
Opštine Elez Han  
Municipality of Hani i Elezit

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosijen e Vijave Llogaridhëse të Agjencive të Pavarura, nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 5 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligjit nr. 08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023, palët nënshkruese janë pajtuar për të nënshkruar këtë:

### MARRËVESHJE TË MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM

#### PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “Ekzodi i Bllacës 99”-Faza e dytë NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

Palët Nënshkruese:

Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale e përfaqësuar nga  
z. Bislim Zogaj, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë

dhe

Komuna e Hanit të Elezit e përfaqësuar nga z. Mehmet Ballazhi, Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit

Neni 1  
Qëllimi

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit nënshkruhet në mes të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe të Komunës së Hanit të Elezit, me qëllim të përcaktimit të obligimeve dhe përgjegjësi të financimit të projektit të përbashkët me titull: “Ekzodi i Bllacës 99” faza e dytë në Komunën e Hanit të Elezit.

Neni 2

#### Mënyra e bashkëfinancimit të projektit

1. Projekti “Ekzodi i Bllacës 99” faza e dytë në Komunën e Hanit të Elezit, sipas planifikimit buxhetor ka koston financiare në total prej 63,600.00 € (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind euro).

2. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale financon këtë projekt në vlerën prej 33,600.00€ (tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind euro) për vitin 2023, nga projekti me kod 18931 i paraparë në buxhetin e Agjencisë për vitin 2023.

3. Komuna e Hanit të Elezit financon këtë projekt në vlerën prej 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro), nga kodi 41641 – Mjete të lira për bashkëinvestime, i paraparë në buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit, për vitin 2023.

### **Neni 3**

#### **Obligimet e Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale**

1. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, në pajtim me ligjin dhe këtë marrëveshje, zoton mjetet për projektin e paraparë në nenin 2 të kësaj marrëveshje dhe një kopje të zotimit e dërgon në Komunën e Hanit të Elezit për realizimin e projektit.

2. Paguesa për financimin e projektit "Ekzodi i Bllacës 99" faza e dytë në Komunën e Hanit të Elezit, nga Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale do të ekzekutohet në pajtim me realizimin e projektit, sipas situacionit dhe raportit të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës dhe Menaxherit të projektit të përcaktuar nga Komuna e Hanit të Elezit .

3. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale mund të caktoj një zyrtar vëzhgues për përcjelljen e zbatimit të "Ekzodi i Bllacës 99" faza e dytë në Komunën e Hanit të Elezit, i cili do t'i raportojë Agjencisë.

### **Neni 4**

#### **Obligimet e Komunës**

1. Komuna e Hanit të Elezit obligohet që për projektin "Ekzodi i Bllacës 99" faza e dytë në Komunën e Hanit të Elezit, në pajtim me ligjin të zhvilloj procedurat që kanë të bëjnë me procesin e tenderimit, vlerësimit dhe dhënies së kontratës.

2. Komuna e Hanit të Elezit, emëron Menaxherin dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, për realizimin e projektit si dhe për inspektimin e punimeve deri në përfundimin e projektit.

3. Komuna e Hanit të Elezit është e obliguar që të njoftoj Agjencinë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për të gjithë hapat e realizimit të projektit.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja e marrëveshjes**



Marrëveshja e lidhur ndërmjet Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe Komunës së Hanit të Elezit përfundon me realizimin e projektit i cili duhet të përmbyllet brenda vitit 2023.

### **Neni 6 Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes**

1. Palët nënshkruese, zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje bashkëfinancimi dhe në rast të kontestit eventual apo paqartësie për zbatimin e kësaj marrëveshje, pajtohen që përmes bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim të gjendet zgjidhje përkatëse, e në të kundërtën pajtohen që për zgjidhjen e kontestit t'i drejtohen gjykatës kompetente.
2. Për plotësimin dhe ndryshimin eventual të kësaj marrëveshje, palët nënshkruese pajtohen që të ndjekin rrugën e njëjtë si për nënshkrimin e marrëveshjes bazë.

### **Neni 7 Pronësia e projektit**


1. Me pranim-dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky projekt i paraparë sipas kësaj marrëveshje të mirëkuptimit, do të regjistrohet në pronësi të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale -AMMKM-së.
2. Ky projekt regjistrohet në pronësi të AMMKM-së në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

### **Neni 8 Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo marrëveshje mirëkuptimi është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë identik dhe secila palë nënshkruese merr nga dy ekzemplarë.
2. Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit fillon të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj.

### **PALËT NËNSHKRUERE TË MARRËVESHJES**

**Bislim ZOGAJ**

  
**Drejtor Ekzekutiv**  
Agjencia për Menaxhimin  
e Monumenteve dhe  
Komplekseve Memoriale



**Mëlimet BALLAZHI**

  
**Kryetar i Komunës**  
Komuna e Hanit të Elezit



Datë: 10.07.2023